

UDHËZIM
Nr.30, datë 4.8.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË “DISPOZITAT NORMATIVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Për akordimin e Medaljes së Artë:

I. Neni 39 “Medalja e Artë” i “Dispozitave normative për arsimin parauniversitar” ndryshon si më poshtë:

“Neni 39
Medalja e Artë

Nxënësit i akordohet “Medalje e Artë”, kur ai plotëson një nga dy kriteret e mëposhtme:

1.

- a) Të ketë notë mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme jo më pak se 9.80.
- b) Në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore të ketë mesataren e notave të shkallëzuara jo më pak se sa 9.80.
- c) Në provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore të ketë mesataren e notave të shkallëzuara 10.00.

2.

a) Është fitues i një prej tri vendeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse.”

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit Parauniversitar, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit dhe DAR/Za-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj